



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Gusht 2026

Data 28.08.2026 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 30.07.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2026.
- 4.Projekt vendim për miratimin e njohjes si posedues jopranarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me Vkm nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5.024 ha "Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin,Gjader, Kirë.
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Pashkë Gazulli në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush".
- 7.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 28.08.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë (Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Saniye Salja, Elton Frashnaj.) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili ftoj këshilltarët që të mbanin 1 minut heshtje në nderim të ish këshilltarit të ndjerit Neki Kapllanaj i cili ka ndërruar jetë me datë 03.08.2026.

Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak lexoi rendin e dites.Pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me propozimin.Këshilltarët shprehen dakortësi.Hidhet në votim rendi i ditës:**Miratohet me 20 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro:(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda,



Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 30.07.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 30.07.2026 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro :(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:

Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj sqaron se mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa (dh), dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës" neni 21, pika 1, germa (f), i propozoj Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të miratojë humbjen e mandatit për ish këshilltarin, të ndjerin Neki Kapllanaj i cili ka ndërruar jetë.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin. **Miratohet me 20 vota Pro, zero kundër, zero abstenim.** Këshilltarët që votuan pro :(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Korrik 2026, familje 119, me 384,401 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Korrik 2026 janë shpallur fitues, 857 familje, me fond 6,413,314 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 384,798 lekë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 3 të rendit të ditës: (Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)



Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e njohjes si posedues jopranarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me Vkm nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Marinel Deda-Drejtore zyres juridike, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se në zbatim të procedurave të ndjekura nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetari të Bashkisë Vau Dejës nr.08, datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si "posedues", "jo pronarë, pasi u njohën me aplikimet e bëra nga subjektet e interesuara në portalin e-albania, mbylljes së korrespondencës zyrtare me ASHK dhe ATP, verifikimit në terren në rastet e mungesës së dëshmitarëve, dhe realizimit të afishimit 45 ditor në webin e faqes zyrtare të bashkisë si dhe pranë cdo njësie administrative ku ndodhet prona, paraqiten bashkëngjitur projekt-vendimit relacioni shpjegues përmbledhës për rastet e kualifikuara për fazën e parë të mbylljes së afishimeve publike.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 4 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 4 të rendit të ditës:(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Saniqe Salja, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5.024 ha "Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin,Gjader, Kirë.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli-specialist inxhinjer pranë zyres pyjeve, Bashkia Vau Dejës i cili spjeron për këshilltarët se janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në ligjin nr 57/2020 "për pyjet". Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016"Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" pika nr 2 germa dhe pika 7. Siperfaqja e marrë në studim do të nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.Pas miratimit të raportit tekniko ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për pregatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet procedurës së konkurimit publik.Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullor bazohen në VKM nr.559, datë 29.07.2022.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 5 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 5 të rendit të ditës:(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda,



Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuara Znj.Pashkë Gazulli në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Marketa Lleshaj-specialiste për strehimin social e cila spjegon se e moshuara Znj. Pashkë Gazulli është e ve dhe ka pasur vetëm një fëmijë, një vajzë, e cila ka qenë e martuar dhe ka jetuar në Itali. vajza e saj e ka ndihmuar financiarisht, duke kontribuar në pagesën e qirasë dhe në shpenzimet e tjera të jetesës.Fatkeqësisht, para pak muajsh, vajza e saj ka ndërruar jetë. Pas humbjes së saj, e moshuara ka mbetur pa mbështetjen e vetme familjare dhe financiare që kishte.Për shkak të moshës, gjendjes familjare dhe mungesës së mbështetjes ekonomike, ajo tashmë e ka shumë të vështirë të përballojë pagesën e qirasë dhe shpenzimet e përditshme të jetesës, të cilat janë bërë të papërballueshme për të.Duke marrë parasysh moshën gjendjen shëndetsore, vetminë dhe mungesën e kujdesit familjar, prpozohet akomodimi i sajë në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush", ku do mund te marre perkujdesjen e nevojshme, sherbimet baze te jetetses, ndihmen mjeksore dhe mbeshtetje sociale te vazhdueshme.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim piken 6 të rendit të ditës:**Miratohet me 20 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**,Këshilltarët që votuan Pro piken e 6 të rendit të ditës:(Rregjinë Shelqetja, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkja, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Ermir Tahiri, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Sanije Salja, Elton Frashnaj)

Pika 7: Të ndryshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime të ndryshme dhe problematikat që mund të kenë hasur në zonë.

Znj.Saniye Salja ngre shqetësimin: Në qendër të fshatit Bushat janë disa rrugë lagjesh që lidhen me qendren e fshatit dhe në hyrje të tyre janë vendosur tabela që ndalojnë qëndrimin e automjeteve, pra ndalojnë që të parkojnë.

Meqenëse banorët dun të kryejnë punë, p.sh pranë bankës, ato nuk kanë ku ti parkojnë automjetet sepse janë tabelat ndaluese të parkingut në këto rrugë.

Kërkoj që të bëhet i mundur lejimi i parkimit të automjeteve në këto rrugë të brendshme të fshatit.

Z.Ervis Shimaj përgjigjet se ky shqetësim do të përcillet institucioneve përkatëse për të marrë zgjidhje.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin për të diskutuar apo për të ngritur problematika.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari Këshillit e deklaroi të mbyllur mbledhjen e radhës, muaji Gusht 2026

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|------------------------------|---------------------------|
| 1. <u>Enis Shiri</u> | 16. <u>Hirez Vasija</u> |
| 2. <u>Franc Grelga</u> | 17. <u>Vlora Sel</u> |
| 3. <u>Franc Grelga</u> | 18. <u>Vlora Sel</u> |
| 4. <u>Meliko Zekaj</u> | 19. <u>Ermir Tahiri</u> |
| 5. <u>Majlinda Khamri</u> | 20. <u>Regina Melgosa</u> |
| 6. <u>Ornela Lleshi</u> | 21. _____ |
| 7. <u>Elton Troshaj</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Arsen Mehmeti</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Rita Bregi</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Kastriot Shkijari</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Allina Liradhi</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Besmir Koci</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Robert Tushi</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Martin Morodoceri</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Mark Biri</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |